



PIRRO PRIFTI

PROF. DR.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KARRIERËS

Prof. Dr Pirro Prifti është Përgjegjës
Departamenti i Formimit të Përgjithshëm
dhe Zhvillimit Profesional

FUSHA E EKSPERTIZËS KËRKIMORE

Anestezi dhe Rehabilitacion, Terapi
Intensive, Emergjencat Mjekësore,
Farmakologji Klinike

EMAIL

priftipirro2017@gmail.com

BIO

Prof. Dr Pirro Prifti është diplomuar në vitin 1997 me gradën shkencore “Doktor” në fushën e mjeksisë pranë Universitetit të Tiranës.

Në vitin 2007, fiton titullin shkencor “Profesor i Asociuar” dhe në vitin 2015, i jepet titulli akademik “Profesor”.

Prof. Dr. Pirro Prifti ka një eksperiencë akademike shumëvjeçare në mësimdhënie pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT) Universiteti Mjekësor i Tiranës si dhe pozicione drejtimi si Përgjegjës Departamenti të Mjeksis/Infermieri si dhe Dekan pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, (UMT), UET.

Prof. Dr Pirro Prifti, ka një karriere profesionale 45 vjeçare si mjek specialist në anestezi-reanimacion. Fillimet e profesionit të tij datojnë prej vitit 1974 si mjek dhe drejtues i qendrës shëndetësore në Zapod, Kukës. Nga vitet 1981-1999 ka punuar mjek anestezist-reanimator pranë QSUT dhe në 1997-1998 ka qenë Drejtor i Spitaleve pranë Ministrisë së Shëndetësisë, Tiranë. Në vitin 1999, përgjatë Luftës në Kosovë ka punuar në emergjencat mjekësore në pozicionin Drejtor i Drejtorive Spitalore po në Ministrinë e Shëndetësisë, Tiranë.

Prof. Dr Pirro Prifti është autor i rreth 40 botimeve në fushën e mjeksisë si në revista kombëtare ashtu dhe të huaja. Autor tekstesh mjekësore dhe librave si udhëzues shkencor, kontributi akademik e profesional i Prof. Dr. Pirro Prifti dallohet edhe për hapjen e programeve të studimit në disiplinat mjekësore dhe hartimin e programeve lëndore.

Ai është Anëtar i Shoqatës së “Anestezi-Reanimacionit” të Shqipërisë dhe Shoqatës së Dhimbjeve.